

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

Komuna e Mamushës

31 Dhjetor 2011

Përmbajtja

<u>Përmbledhje</u>	2
1 <u>Hyrie</u>	5
2 <u>Opinion i Auditimit</u>	7
3 <u>Gjendja e rekomandimeve të vitit paraprake</u>	11
4 <u>Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar</u>	12
5 <u>Pasqyrat Financiare–Pajtueshmëria me kornizën raportimit dhe cilësinë e informatave</u>	13
6 <u>Menaxhimi Financiar</u>	14
• <u>6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetanake)</u>	14
• <u>6.2 Shpenzimet</u>	15
• <u>6.3 Asetet</u>	16
• <u>6.4 Trajtimi i borxheve</u>	17
• <u>6.5 Raportimi dhe afati kohor aktual ne procesin e pergjithshëm të buxhetit</u>	18
7 <u>Kontrollet e menaxhmentit</u>	19
• <u>7.1 Sistemi i kontrollit të brendshëm</u>	19
• <u>7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm</u>	19
8 <u>Një konkluzion I përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës së Mamushes</u>	20
<u>Shtojca I: Llojet e ndryshme të opinioneve të auditimit të bazuara në ISSAI 400</u>	21
<u>Shtojca II: Rekomandimet e viteve paraprake</u>	23
<u>Shtojca III: Komentet e Komunës dhe përgjigjet nga Auditori</u>	30

Përmbledhje

Grant Thornton Shpk, në emër të Auditorit Gjeneral, ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Mamushës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Auditimi jonë është kryer në përpuethshmëri me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (“ONISA”) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion mbi pasqyrat financiare.

Ju lutem më poshtë gjeni një ekstrakt të marrë nga mendimi ynë i auditimit në faqen 7 të këtij dokumenti:

Sipas mendimit tonë, përveç impakteve të mundëshme të çështjeve të diskutuara në paragrafet 1 deri 5 të bazës së opinionit të kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe pagesat për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik bazuar në Paranë e Gatshme (“SNKSP”) Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe Rregullës Financiare Nr. 07/2011 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore.

Porositë kryesore ndaj Kryetarit, të cilat na shpjen në kualifikim të opinionit janë:

1. Shpalosje të caktuara të kërkuara nga SNKSP Raportimi Financiar Sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe Rregullit Financiar Nr. 07/2011 në Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore nuk janë kryer nga ana e Komunës gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare më dhe për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011. Në veçanti, çështjet në vijim mungojnë ose janë shpalosur në mënyrë të gabuar në pasqyrat financiare:
 - Neni 12 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave nuk është në pajtueshmëri me shumat aktuale të raportuara në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave në Kosovë (“SIMFK”).
 - Neni 12 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave nuk është kompletuar në mënyrë të duhur dhe nuk është në pajtueshmëri me Shënimin 2 dhe 8.
 - Pagesat nga palët e treta, në Nenin 12 të Pasqyrës së pranimeve dhe pagesave nuk janë shpalosur për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.
 - Neni 13 Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit nuk është kompletuar në mënyrë të duhur.
 - Të arkëtueshmet (për organizatat buxhetore që mbledhin të Hyra) nuk janë të kompletuara

- Ligji Nr. 03/L-221 – Raporti mbi veprimet e marra dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet e auditorit për vitin 2010 nuk është përfunduar në mënyrën e duhur.

Si pasojë ne nuk mundëm të marrim siguri të arsyeshme mbi plotësinë dhe pajtueshmërinë rregullative të informatave financiare të prezentuara në pasqyrat financiare të Komunës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

2. Informacioni krahasues për vitet 2010 dhe 2009 nuk është prezantuar në mënyrë të duhur:

- Të dhënat e prezentuara në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011 janë prezantuar në shuma totale në Euro, përderisa të dhënat krahasuese janë të paraqitura në mijëra Euro.
- Neni 17 Bilanci i të hyrave të papritura vetanake nuk është shpalosur në mënyrë të duhur për vitin 2010.

3. Komuna nuk e mban listën e pagesave nga palët e treta. Si pasojë enatyrës së regjistrimeve të mbajtura në sistemetet operacionale dhe kontabël për pagesat nga palët e treta, si dhe për shkak të mungesës së kontrolleve alternative të implementuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim në gjendje të kryejmë testime auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme që të verifikojmë plotësinë e pagesave nga palët e treta të njohura për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

4. Prona, objektet dhe pajisjet nëpronë të Komunës janë shpalosur në pasqyrat financiare. Sidoqoftë, ka mangësi dhe pasiguri të cilat ndikojnë raportimin e pronës, objekteve dhe pajisjeve të Komunës si në vijim:

- Bilanci i pronës, objekteve dhe pajisjeve siç është shpalosur në Pasqyrat Financiare të Komunës për 31 Dhjetor 2011 shënimi 27 nuk harmonizohet me regjistrin e asetëve. Për më tepër, Komuna nuk ka regjistruar pronë, objekte dhe pajisje në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (referuar si “SIMFK”).
- Komuna nuk ka caktuar Komision për Vlerësim të Pronës dhe nuk ka kryer asnjë vlerësim të asetëve të saj për 31 Dhjetor 2011. Ata do duhej të kryenin vlerësim të të gjitha kategorive të asetëve: atyre në përdorim, asetëve të dëmtuara, pronës të patransferueshme, dhe të vlerësojë kërkesa për tjetërsim të pronës.

Si pasojë e natyrës së regjistrimeve dhe mangësive të tjera të përshkruara më lartë, ne nuk kemi mundur të jemi të kënaqur me shpalosjet, ekzistencën, plotësinë, saktësinë dhe vlerësimin e pronës, objekteve dhe pajisjeve të Komunës për 31 Dhjetor 2011.

5. Më 31 Dhjetor 2011, Komuna nuk ka shpalosur në mënyrë të duhur llogaritë e saj të arkëtueshme lidhur me tatimin në pronë, tatimi mbi licencë biznesi dhe të arkëtueshme të tjera tatimore, të cilat kërkohet nga Rregulli Financiar 07/2011. Për më tepër, Komuna nuk mirëmban regjistër të kompletuar të borxhlinjëve. Si pasojë, ne nuk kemi mundur të jemi të kënaqur me bilancin e llogarive të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2011.

Kontrollet e brendshëme

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto mangësi janë përshkruar në detaje brenda këtij raporti. Konkluzioni ynë është se sistemet e brendshme të Komunës nuk janë dizajnuar në mënyrë të duhur për të eliminuar dobësitë evidente dhe nuk janë implementuar në mënyrë të duhur. Në mënyrë që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollet e brendshme, ne ju rekomandojmë që të siguroni :

- Pasqyrat financiare janë të pregaditura në pajtim me udhëzimet aktuale administrative dhe SNKSP;
- Një listë gjithëpërfshirëse e pronës, objekteve dhe pajisjeve të mirëmbahet;
- Një sistem automatik i faturimit për të gjitha llojet e taksave mirëmbahet;
- Ndë rmirren masa për të ngritur mbledhjen e të hyrave nga taksa të ndryshme;
- Ligji Nr. 03/L-241 i ndryshuar 04/L-042 'Ligji per Prokurimin Publik në Kosovë' është I zbatuar në mënyrë të plotë; dhe
- Një Njësi Auditimi dhe Komision Auditimi janë themeluar.

Menaxhmenti të Komunës i është dhënë mundësia të komentojë në gjetjet e paraqitura në këtë raport. Menaxhmenti ka rënë dakord të bëjë të gjitha përpjekjet për të adresuar rekomandimet tona në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm, pasqyrat financiare, pagat dhe rrogat, prokurimin, borxhet, zgjidhjen e të arkëtueshmëve dhe themelimi i një Njësi të Auditimit dhe themelimin e Njësisë të Auditimit dhe Komisionit të Auditimit.

Tutje, në fund të vitit 2010 dhe në fillim të vitit 2011 vlerësimi i PShFP-së (Përgjegjësia e Shpenzimeve dhe Financave Publike), ngjajshëm me atë Qeveritare në nivelin ndërkombëtar është zhvilluar për pesë komuna të Kosovës, e cila ka rezultuar në zhvillimin e një plani veprues për të reformuar MFP (Menaxhimin e Financave Publike) për komunat që kanë marë pjesë në këtë proces. Komuna e Mamushës ka qenë njëra nga pjesëmarrëset. Vlerësimi është kryer në menaxhmentin financiar publik të kryer në katër kategori kryesore siç janë Kredibiliteti Buxhetor, gjithëpërfshirja dhe transparenca, Cikli Buxhetor dhe Praktika e Donatorëve. Konkluzioni i përgjithshëm ishte se Menaxhmenti Financiar Publik i komunës së Mamushës ka fusha të dobëta në të gjitha kategoritë e lartpërmendura dhe ka nevojë për përmirësime.

1. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Mamushës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Është përgjegjësia e Komunës të përgatisë pasqyrat financiare në pajtueshmëri me Rregullin Financiar 07/2011 dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për “Raportimin Financiar në baze të kontabilitetit të parasë së gatshme.”

Grant Thornton Shpk, në emër të Auditorit të Përgjithshëm, është përgjegjës për kryerjen e auditimit të rregullt vjetor të pasqyrave financiare të Komunës të dhe për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Auditimi është një verifikim i kontabilitetit financiar, që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vertetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksionit të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për çështjet e tjera të cilat dalin nga apo kanë të bëjnë me auditimin.

ZAP ka kryer auditimin e ndërmjetmë të Komunës. Gjatë fazës së procesit të auditimit kanë vlerësuar adresimin e rekomandimeve të mëparshme dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Duke u bazuar në këto kanë dhënë rekomandime menaxhmentit. Rekomandimet e tyre gjithashtu përfshijnë këshilla në lidhje me përmirësimet që pasqyrat financiare të jenë në pajtim me Rregullin Financiar 07/2011 dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar të Kontabilitetit në baza të Parasë së Gatshme.” Gjithashtu përfshijnë këshilla lidhur me përgatitjen e Pasqyrave Vjetore Financiare. Rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm janë dorëzuar përmes një memorandumi të auditimit të datës Dhjetor 2011.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e Komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi krahasuar pasqyrat vjetore financiare të komunës në raport me buxhetin e aprovuar më dhe për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat vjetore financiare të Komunës janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe Rregullin Financiar 07/2011;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare; dhe

- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimeve të dokumenteve dhe verifikimit fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe drejtësinë e transaksioneve.

Në këtë raport ne përmbledhim gjetjet e auditimit dhe japim opinionin tonë mbi Pasqyrat Vjetore Financiare më dhe për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

ONISA përcakton kriteret specifike, të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet në lidhje me opinionin e auditimit tonë për pasqyrat vjetore financiare të Komunës.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 1.

2. Opinioni i Auditimit

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala 18
10 000 Prishtina
Republic of Kosovo

T +381 38 247 771
T +381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.grant-thornton.com.mk

Drejtuar: Kuvendit Komunal
Komuna e Mamushës, Kosovë

Ne kemi audituar e pasqyrat financiare të Komunës së Mamushës, ("Komuna"), që përbëhen nga pasqyra e pranimeve dhe pagesave për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011, një krahasim i buxhetit dhe shumave aktuale dhe një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik – SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme," me Rregulli Financiar Nr. 07/2011 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore, dhe për të tilla kontrole të brendshme sic menaxhmenti i përcakton që janë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare që janë të lira nga paraqitjet e gabuara materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me standardet ndërkombëtare të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA). Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në përputhshmëri me kerkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi të auditimit lidhur me shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë gabim ose mashtrim. Gjatë vlerësimit të riskut, auditori konsideron kontrollin e brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim që të dizajnojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në ato rrethana, por jo për qëllimin e shprehjes së një mendimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu dhe vlerësimin e prezentimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmia e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e duhur për të siguruar bazë për mendimin tonë të kualifikuar.

Bazat për Opinion të Kualifikuar

1. Shpalosje të caktuara të kërkuara nga SNKSP Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe Rregullin Financiar Nr. 07/2011 *mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore* nuk janë bërë nga Komuna gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare më dhe për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011. Në veçanti, çështjet në vijim janë lënë jashtë ose janë nuk janë shpalsour në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare:
 - Neni 12 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave nuk është përfunduar në mënyrën e duhur dhe nuk përputhet me shënimin 2 dhe 8.
 - Pagesat nga palët e treta, në seksionin 12 të Pasqyrës për pranime të parasë së gatshme dhe pagesa nuk janë shpalosur për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.
 - Seksioni 13 Raporti për Ekzekutimin e Buxhetit nuk është përfunduar (kompletuar) në mënyrën e duhur.
 - Të arkëtueshmet (të përdorura për mbledhjen e të hyrave të organizatave) nuk është kryer në mënyrën e duhur.
 - Ligji nr. 03/L-221 – Veprimet e raportuara, ta ndërmarra dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet e auditorit për vitin 2010 nuk është kryer në mënyrën e duhur.

Prandaj ne nuk kemi mundur të marrim siguri të arsyeshme lidhur me kryerjen dhe përputhshmërinë e rregullt të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare të Komunës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

2. Informacioni krahasues për vitet 2010 dhe 2009 nuk është paraqitur në mënyrën e duhur:
 - Të dhënat e paraqitura në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011 janë të paraqitura në shuma totale në Euro përderisa të dhënat krahasuese janë të paraqitura në mijëra Euro.
 - Seksioni 17 Bilanci i të hyrave vetanake të papritura nuk është shpalosur në mënyrën e duhur për vitin 2010.
3. Komuna nuk e mban listën e pagesave të palëve të treta. Për shkak të natyrës së regjistrimeve të mbajtura në sistemetet operacionale dhe të kontabilitetit për pagesat e palëve të treta, si dhe për shkak të mungesës së kontrolleve alternative të implementuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim në gjendje të kryejmë teste të mjaftueshme dhe të përshtatshme që të verifikojmë kompletueshmërinë e pagesave nga palët e treta të njohura për fund vitin më 31 Dhjetor 2011.
4. Prona, objektet dhe paisjet nëpronësite Komunës janë shpalosur në pasqyrat financiare. Sidoqoftë, ka shumë mangësi dhe pasiguri që prekin raportimin financiar të pronës, objekteve dhe paisjeve të Komunës si në vijim:

- Bilanci i pronës, dhe paisjeve siq është shpalosur në pasqyrat financiare të Komunës për 31 Dhjetor 2011 shënimi 27 nuk përputhet me regjistrin e asetëve. Tutje, Komuna nuk ka regjistruar pronë, objektet dhe paisjet në Sistemin e Informimit të Menaxhimit të Financave të Kosovës (referuar si “SIMFK”).
- Komuna nuk ka caktuar Komision për vlerësim të Pronës dhe nuk ka kryer ndonjë vlerësim të asetëve të sajë për 31 Dhjetor 2011. Ata do duhej të kryenin vlerësim të të gjitha kategorive të asetëve: atyre në përdorim, asetëve të dëmtuara, prona të pa-transferueshme, dhe vlerësimi i kërkesave për tjetërsim të pronës.

Për shkak të natyrës së të dhënave dhe mangësive të tjera siq është përshkruar më lartë, ne nuk kemi mundur të jemi të kënaqur më shpalosjet, ekzistencën, kryerjen, korrektësinë dhe vlerësimin e pronës, objektve dhe paisjeve të Komunës për 31 Dhjetor 2011.

5. Për 31 Dhjetor 2011, Komuna nuk ka shpalosur në mënyrën e duhur në llogaritë e arkëtueshme lidhur me tatimin në pronë, tatimin për licencë biznesi dhe tatim për të tjera të arkëtueshme që kërkohet nga Rregulli Financiar 07/2011. Prandaj, Komuna nuk mirëmban regjister të kompletuar të borxheve. Si pasojë ne nuk kemi mundur të jemi të kënaqur në lidhje me bilancin e llogarive të arkëtueshme për 31 Dhjetor 2011.

Opinion i Kualifikuar

Sipas mendimit tonë, përveç impakteve të mundshme të çështjeve të diskutuara në paragrafin 1 deri 5 të bazës së opinionit të kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe pagesat për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik bazuar në Paranë e Gatshme (“SNKSP”) Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe Rregullës Financiare Nr. 07/2011 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore.

Rishikim i përputhshmërisë

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse në të gjitha aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato. Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara krahasuar me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare.

Përgjegjësia e menaxhmentit për përputhshmërinë

Menaxhmenti është përgjegjës për dizajnimin dhe zbatimin e kontrollit të brendshëm që të sigurojë se aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e pasqyruara janë në përputhshme me autoritetet që i qeverisin ato.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjithë aspektet materiale me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie.

Ne besojmë se dëshmia e auditimit që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

Konkluzion dhe përputhshmëri

Bazuar në rishikimin tonë, për shkak të ndikimit në pasqyrat financiare të çështjeve të shpjeguara në paragrafët 1 deri 5 të “bazat për mendim të kualifikuar” dhe çështjeve të tjera të theksuara në pikat 3 dhe 8 të këtijë raporti, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e pasqyruara dhe pasqyrat financiare që duhet të kenë vëmendjen tonë gjatë rishikimit, nuk janë në përputhshmëri me autoritetet që i qeverisin ato..

Çështje të tjera

I kushtojmë vëmendje çështjeve në vijim:

1. Burimi kryesor i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance. Sidoqoftë, Free balance nuk është duke u përdorur për të regjistruar pagesa nga palët e treta, prona dhe paisjet ose të të arkëtueshmëve, nuk mund të përdoret për të prodhuar pasqyra financiare gjithpërfshirëse;
2. Edhe pse Kryetari dhe Shefi Financiar kanë nënshkruar një Deklaratë në lidhje me prezentimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ka dorëzuar një draft final të pasqyrave financiare në gjuhën Serbe në fund të auditimit tonë përderisa duhet të bëjnë këtë para datës 31 Janar;
3. Komuna nuk ka zbatuar një sistem gjithpërfshirës dhe automatik të faturimit dhe nuk mirëmban nën-llogari ose lista të ndara për të gjithë borxhlinjtë në lidhje me tatime të ndryshme. Përkundër kësaj, vetëm mbledhjet e parasë së gatshme nga derdhjet e të hyrave janë regjistruar. Edhe pse të arkëtueshmet kërkohet të jenë të shpalosura, nuk është bërë një hpalosje e tillë në pasqyrat financiare të Komuës. Mungesa e korrektësisë dhe kryerjes do të ndikojë të hyrat që mund të fitojë Komuna dhe mundësinë të pregadisë buxhet të besueshëm dhe të duhur, të raportojë mbledhje tatami të duhur, dhe të monitorojë mbledhjen e të hyrave vetanake në baza kohore.
4. Kemi identifikuar dy raste të mos-përputhshmërisë me ligjin Nr. 03/L-241 dhe 04/L-042 “Ligji për Prokurim Publik në Kosovë” (i ndryshuar). Mos-përputhshmëria e tillë e lidhur me procedurat e kërkuara të cilat nuk janë kryer dhe dokumentuar nga Komuna.

Grant Thornton LLC

Prishtinë, Kosovë
29 Qershor 2012

3. Gjendja e Rekomandimeve të vitit paraprak

Letra jonë për menaxhmentin, për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010, ka identifikuar gjashtë rekomandime kyçe. Njëra nga këto rekomandime e ndërlidhur me dosjet e punëtorëve është zgjidhur dhe prona,objekteti dhe paisjet pjesërisht janë zgjidhur, përderisa katër rekomandimet e tjera ende mbesin të adresohen:

- Pasqyrat financiare duhet të pregaditen në përputhshmëri me instruksionin adminsitrativ dhe SNKSP;
- Një sistem automatik i faturimit për të gjitha llojet e taksave duhet të vendoset në vend, përputhshmëritë e të hyrave në mes të zyrtarit për të hyra vetanake dhe departamentit operacional duhet të kryet, duhet të bëhen dhe matjet për të rritur mbledhjen e të hyrave nga taksa të ndryshme;
- Duhet të sigurohet përputhshmëria me Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë; dhe
- Duhet të themelohet një Komision për Auditim dhe funksion të auditimit të brendshëm.

Dështimi për të adresuar rekomandimet e dhëna, n aka bërë ne të kemi gjetje të ngajshme sikur në vitin 2010.

4. Rezultatet financiare krahasuar me buxhetin e aprovuar

Analiza e Rezultatit Aktual në Pasqyrat Financiare krahasuar me Buxhetin e Aprovuar tregon:

Tabela 1: Rishikim të buxhetit dhe shpenzimet aktuale

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	Pranimet/ Shpenzimet 2011	Pranimet/ Shpenzimet 2010
I.Total pranime dhe transfere të donatorëve	1,033,579	1,108,631	979,097	770,182
Grant-Buxheti Qeveritar	966,262	993,262	966,867	753,671
Të hyrat vetanake	67,317	108,722	6,200	16,511
Donacionet e vendit	-	-	-	-
Donacionet e jashtme	-	6,647	6,030	-
II.Total shpenzime	1,033,579	1,108,631	979,097	770,182
Pagat dhe rrogat	631,432	658,432	636,208	507,555
Mallrat dhe shërbimet	75,123	87,970	83,493	111,097
Shpenzimet komunale	21,122	21,122	21,037	20,972
Subvencionet dhe Transferet	1,547	1,547	1,547	1,430
Investimet kapitale	304,355	339,560	236,812	129,128
Rezervat	-	-	-	-
Diferenca I-II	-	-	-	-

Sipas të dhënave të prezentuara në tabelën më poshtë, mund të vërejmë se buxheti final i Komunës së Mamushës ishte 1,108,631 Euro gjatë vitit 2011. Shpenzimet totale për vitin 2011 ishin në shumë prej 979,097 Euro, ose rreth 88.3% të buxhetit final. Buxheti i pashpenzuar në fund të vitit 2011 ishte në shumë prej 129,534 Euro ose 11.68%.

Buxheti final ishte më i lartë sesa buxheti fillestar në shumë prej 75,052 Euro sepse gjatë vitit kategoria e mallrave dhe shërbimeve është rritur në shumë prej 6,647 Euro dhe kategoria e investimeve kapitale është rritur në shumë prej 41,405 Euro, përderisa pjesa e mbetur e diferencës nga Fondi i Përgjithshëm iu referohet rrijtes buxhetore për rroga e vendosur në nivelin qeveritar.

Konkluzion

Sipas vlerësimit tonë, Komuna nuk ka shpenzuar buxhetin total për vitin 2011 në përputhshmëri me projeksionet dhe kufijt e vënë nga Kuvendi i Kosovës.

Niveli i ulët i zbatimit të programit për investime kapitale tregon se ka dobësi në procesin e planifikimit, menaxhimit dhe monitorimit të ekzekutimit të kontratave për investimet kapitale të Komunës.

1 Rekomandim

Ne rekomandojmë Kryetarin të sigurojë që:

- Kontrolli i brendshëm lidhur me përdorimin e buxhetit në përputhshmëri me planifikimin të permisohet; dhe
- Kontrollat për planifikim, menaxhim dhe monitorim të investimeve kapitale të përmirësohen në mënyrë që të arrijnë efektshmëri më të lartë të ekzekutimit të kontratës në kohë të caktuar.

5. Pasqyrat financiare – Përputhshmëria me kornizën raportuese dhe kualiteti i informacionit

Kërkesat e LMFPP nr. 03/L-048 dhe Rregulli Financiar 07/2011.

- Pasqyrat financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar i Komunës së Mamushës;
- Pasqyrat financiare janë nënshkruar përbrenda kornizës kohore më 31/01/2012 dhe janë dorëzuar tek MF;
- Pasqyrat financiare janë dorëzuar vetëm në gjuhën Shqipe; dhe
- Komuna nuk ka pregaditur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore në MF gjatë vitit 2011.

2 Rekomandim

Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës të sigurojë që pregaditja e pasqyrave financiare të komunës duhet të përfshijë procedura dhe mjete të cilat janë të dizajnuara për të siguruar që informacioni i kërkuar është regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare.

Komuna gjithashtu duhet të pregadisë pasqyrat financiare në gjuhën Serbe.

Kualiteti i informacionit

Gjetjet

Gjetjet dhe rekomandimet tona të auditimit në këtë dokument sugjerojnë që përmirësimet duhet të bëhen në kualitetin e pranuar të informacionit dhe të prezentohen në pasqyrat financiare.

3 Rekomandim

Ju lutem shihni rekomandimet tona në këtë dokument për këshillë se si kualiteti i informacionit mund të përmirësohet.

6. Menaxhimi financiar

6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetanake)

Gjetjet

- *Sistemet e faturimit.* Një system automatik i faturimit ekziston vetëm për tatim në pronë. Për kategori të tjera të të hyrave për të cilat kërkohet sistemi i faturimit, ky sistem nuk është zbatuar. Përkundër kësaj, vetëm mbledhjet e parasë së gatshme nga të derdhejt e të hyrave të tilla janë regjistruar.

Dobësitë në sistemin automatik të faturimit. Sistemi i faturimit të tatimit në pronë është centralizuar dhe Komuna nuk ka mundur të rishikojë dhe monitorojë në mënyrën e duhur mbledhjen e të hyrave ashtu siq është bërë në mënyrën automatike nga sistemi i ri. Raste mund të ketë ku klienti ka paguar tatim në pronë, por të shumta e mbledhur nuk është regjistruar në sistem dhe klienti është ngarkuar me gjobë edhe pse ka paguar tatimin në kohë.

Sistemi i faturimit lidhur me tatimin në pronë nuk shfaq të gjithë borxhlinjtë e faturuar dhe të arkëtueshmet për 31 Dhjetor 2011.

- *Të hyrat nga licencat e biznesit.* Komuna ka ndërmarrë veprim dhe ka kërkuar të konfirmojë një numër të bizneseve të drejtuara në Komunë me një listë të bizneseve për Autoritetet Tatimore ose Qendrën për Regjistrim të Bizneseve në Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë por ende nuk ka pranuar informacion nga autoritetet relevante. Prandaj, bizneset joaktive ose të mbyllura mund të ngarkohen, përdërisa bizneset e reja ose aktive të mos ngarkohen.
- Bazuar në Rregullin Financiar 07/2011, për 31 Dhjetor 2011, Komuna është e obliguar të raportojë llogaritë e saj të arkëtueshme të ndërlidhura me tatimin në pronë, tatimin për licencat biznesore dhe tatimin për të arkëtueshmet tjera po që shpalosjet janë të pasakta për 31 Dhjetor 2011.
- Përputhshmëria në mes të Zyrtarit për të Hyrat Vetanake dhe Departamentit të Thesarit është bërë për tremujor për shumën totale të të hyrave. Gjatë vitit 2011 kemi identifikuar që nuk është kryer asnjë harmonizim në mes të regjistrave kontabël, regjistrave të siguruar nga zyrtari për të hyrat vetanake dhe departamenti operacional, kështuqë diferencat ekzistojnë kur krahasohen të dhënat nga këto dy burime.
- Mbledhja e të hyrave nga pjesëmarrja e departamentit të Shëndetësisë nuk është transferuar në bankë në baza ditore.

Konkluzion

Mungesa e korrektësisë dhe kompletimit të listave të llogarive të arkëtueshme do të ndikojë të hyrat që mund të arkëtojnë Komuna. Pa regjistra të mjaftueshëm, të detajuar dhe korrekt të borxhlinjëve dhe raporte për mbledhjet, Komuna e ka të pamundur të pregadisë buxhet të besueshëm dhe korrekt, si për raport për mbledhjen korrekte të tatimit, ose të merret me mbledhjen e të hyrave vetanake në baza kohore. Tutje, mbledhja e ulët e të hyrave do të ndikojë kapacitetin investues të Komunës.

Kontrollet jo të duhura dhe të pa mjaftueshme të ndërlidhura me të hyrat dhe programi i ndërlidhur dhe sistemi i faturimit rrisin riskun e manipulimit me shifra dhe keqpërdorim të informacionit. Sistemi i tillë mund të çojë deri tek faturimi i pakompletuar dhe të hyra jo të plota.

Regjistrimi manual dhe mungesa e kufirit të faturimit dhe sistemi kontabël ekspozon Komunën tek risqe dhe gabime shtesë. Për më tepër, shkakton kosto për mbajtje regjistrash, rishikim dhe harmonizim të informacionit.

Lista e re dhe e detajuar e tatimpaguesve individual, bizneset aktive dhe debitorët (borxhlinjtë) e gjeneruar nga sistemi janë të rëndësishëm veçanërisht në situatën aktuale ku Komunitat nuk regjistrojnë secilin transaksion individual në Free Balance. Si pasojë, përveç tatimit në pronë, Thesari dhe Komuna nuk janë të siguruar me një listë të detajuar të pregaditur nga sistemi kontabël ose sistemi i faturimit. Si rezultat, nuk është e mundur të kryhet një harmonizim i duhur ose analizë nga debitori (borxhliu).

4 Rekomandim

Ne i rekomandojmë Kryetarit të sigurojë që Komuna do të ndërmerr hapat për të përmirësuar sistemin e faturimit dhe kontabël në mënyrë që të sigurojë kontrolle të sigurta, efektive të faturimit dhe të të hyrave. Përmirësimi i procedurave të ndërlidhura me sisteme të tilla do të mundësonte për menaxhmentin të monitorojë dhe menaxhojë risqe të rëndësishme, dhe të sigurojë që vendimet e ndërlidhura me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur në mënyrën e duhur. Ne rekomandojmë që Komuna:

- Implementojë një sistem faturimi i cili përfshinë detaje të rifreskuara lidhur me pagesit, adresën e tyre aktuale, historinë dhe klasifikimin e mbledhjes. Informacioni i tillë duhet të jetë i lejuar vetëm për një numër të kufizuar të njerëzve dhe me autorizim nga menaxhmenti.
- Të ekzistojë një lidhje automatike në mes të sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë që informacioni të procesohet automatikisht në librin kryesor të kontabilitetit.
- Të ushtrojë barazime të rregullta midis dysistemeve në periudha të rregullta për të gjitha llojet e të hyrave. Në rastet kur ka diferenca, atoduhet të hulumtohen dhe të zgjidhen brendaafatit të caktuar.
- Të lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta në mes tyre, për rastet ku faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh i transaksioneve.
- Për të marrë informacione nga Qendra e Regjistrimit të Biznesit në Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë në lidhje me bizneset të cilat operojnë në Komunë dhe të ngarkojë ato për tatimet e përshkruara nga Ligjet dhe Rregulloret.

6.2 Shpenzimet

6.2.1 Kompensimet (Pagat dhe Mëditjet)

Gjetjet

Nuk ka gjetje për të raportuar në këtë fushë.

6.2.2 Prokurimi

Gjetjet

Gjatë inspektimit tonë të dokumenteve burimore për shembullin tonë të dosjeve të prokurimit të cilat mbulojnë 52% të pagesave të investimeve kapitale kemi vërejtur disa mos-përputhje me procedurat sipas kërkesës së Ligjit për Prokurim Publik. Këto mos-përputhshmëri janë të përshkruara më poshtë:

- Në Projektin “Furnimizmi me elektro-transformatorë” me ID Nr. 626/11/012/121 dhe vlerë të kontratës 19,998 EURO dhe “Ndërtimi i rrugësme pllaka betoni” me ID Nr. 626/11/006/521 dhe vlerë të kontratës 38,957 EURO dhe annex kontratë 3830 është bërë një vonesë në përfundimin e punës (në rastin e parë për 18 ditë ndërsa në rastin e dytë për 24 ditë), dhe Komuna nuk ka pranuar ndonjë informacion për vonesën. Gjithashtu Komuna nuk ka zbatuar gjoba siq shihet në marrëveshjen e kontratës në rast se puna nuk është kryer në kohë.

5 Rekomandim

Komuna duhet të themelojë procedura të kontrollit adekuate të mjaftueshme për monitorim efektiv mbi përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme.

Ne e këshillojmë Kryetarin të sigurojë që Komuna të zbatojë në mënyrën e duhur kushtet e kontraktuara dhe të aplikojë gjoba kur kontraktuesi përfundon projektin në kohë. Kjo zbatohet veçanërisht kur kërkesa për të zgjatur afatin skadon siq është e përcaktuar në kontratë, nuk është dorëzuar.

6.2.3 Subvencionet dhe transferet

Gjetjet

Komuna nuk ka politika të shkruara për subvencionet, që do të përmbanin kritere dhe procedura për lejimin e subvencioneve, kështu që subvencionet lejohen në bazë të vendimit të kryetarit të Komunës.

Konkluzion

Mungesa e komunikimit me kohë dhe aprovimet nga të autorizuarit apo dokumentimi i pakompletuar mund të çoj në mos pajtueshmëri me Ligjin dhe Kërkesat kontraktuale dhe humbje domethënëse.

6 Rekomandimi

Komuna duhet të themelojë procedura të kontrolleve adekuate të mjaftueshme për monitorimin efektiv në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret aplikative.

6.3 Asetet

6.3.1 Trajtimi i kapitalit dhe asetëve jo-kapitale

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit, mbajtja e regjistrave dhe menaxhimi i asetëve jo-financiare në PRB përputhet me kërkesat e Instruksionit Administrativ nr.21/2009 për Menaxhimin dhe regjistrim të asetëve qeveritare. Kemi vërejtur disa mos-përputhje me instruksionin Administrativ:

Gjetjet

Komuna nuk ka procedura të dokumentuara për njohje dhe kontabilitet të pronën e sajë, objektet dhe paisjet. Për më tepër, Komuna mirëmban regjistër të ndarë të asetëve dhe nuk ka regjistruar të njëjtat në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave në Kosovë (SIMFK) dhe nuk mirëmban regjistër të ndarë për asete nën 1,000 Euro. Për më tepër, Komuna ka kryer llogaritje vjetore dhe verifikim të ekzistencës fizike të asetëve për 31 Dhjetor 2011 por nuk ka barazuar librat e sajë me regjistrat e llogaritjes fizike që nuk është në përputhshmëri me kërkesat e Instruksionit Administrativ nr. 21/2009 për Menaxhimin e Pronës Qeveritare.

Komisioni i inventarit nuk ka pregaditur raportin e inventarit lidhur me inventarizimin e PPE-së më poshtë:

- Nuk kanë pregaditur raporte të ndara lidhur me asetet me vlerë të pa-transferuar, për asetet e dëmtuara dhe të shpalosura.
- Nuk kanë kryer barazim (harmonizim) në mes të kontrollit fizik të PPE-së dhe regjistrave kontabël.

Konkluzion

Komuna nuk ka regjistra të kompletuar dhe korrekt për asetet. Kjo dobësi e kontrolleve të brendshme lidhur me këto asete mund të shpie në asete të përvetësuara dhe të mos identifikuar si të tilla në baza kohore. Për më tepër, menaxhmenti mund të humb kohë dhe mund për të identifikuar detajet dhe vlerën bartase të aseteve, gjatë cfarëdo procesi të ndërlidhur të vendimmarrjes.

Komuna mund të mos jetë në gjendje të kontrollojë përdorimin aktual të pronës së sajë nga ndonjë palë e tretë, dhe si pasojë mund të mos mbledh të hyrat e qirasë për prona të tilla.

7 Rekomandim

Ne i rekomandojmë kryetarit që të sigurojë se Komuna do të merr në konsiderim çështjet në vijim:

- Veprime konkrete do të ndërmerren, që do të mundësojnë regjistrim të menjëhershëm për të gjitha asetet në regjistra relevant në përputhshmëri me kërkesat e IA nr. 21/2009 dhe të cilat janë raportuar në mënyrë korrekte dhe të kompletuar.
- Përfshijë burime shtesë dhe vlerësim të aseteve të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe të çertifikuar është e rekomanduar si praktika më e mirë për raste të tilla.
- Kryerja e llogaritjeve të rregullta fizike për të siguruar ekzistencën e aseteve dhe kushteve të tyre dhe të pajtohet me rezultatet e llogaritjeve me regjistrat kontabël dhe regjistrin.

6.4 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të pa paguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2011 ka qenë 10,738 Euro. Këto detyrime janë bartur tutje për tu paguar në vitin 2012.

Gjetjet

Gjatë auditimit tonë, ne kemi identifikuar disa raste ku pagesat janë bërë pas më shumë se 30 ditëve të datës së pranimit të fakturës që nuk është në përputhshmëri me provizionet e Udhërrëfyesit të Thesarit dhe rregullit financiar 02-Shpenzimet e parasë publike.

Konkluzion

Duke pasur parasysh më lartë, ankesa të ndryshme ligjore mund të kërkohen në të ardhmen dhe prandaj ekziston risku për vënie të gjobave shtesë kundër Komunës.

8 Rekomandim

Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës të ndjek të gjitha provizionet e Udhëzuesit të Thesarit dhe rregullit financiar 02 – Shpenzimet e parasë publike e lëshuar nga Qeveria e Kosovës dhe të zgjidh detyrimet përbrenda 30 ditëve.

6.5 Raportimi aktual dhe kohëzgjatja në procesin e përgjithshëm buxhetor

Komuna ka përmbushur obligimet e raportimit të sajë të jashtëm. Obligimet e përmbushura janë:

- Kërkesa buxhetore;
- Raportet tremujore duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë-mujore;
- Draft plani i prokurimit në kohë; dhe
- Raportet për borxhe të dorëzuara tek MF.

Gjetjet

Gjatë auditimit tonë, kemi identifikuar që Komuna nuk ka pregaditur dhe dorezuar raporte të rregullta tremujore për MF gjatë vitit 2011.

Konkluzion

Komuna e Mamushës nuk ka përmbushur kërkesat ligjore lidhur me raportimin e jashtëm. Menaxhmenti i Komunës duhet të merr matjet e menjëhershme për t'iu adresuar atyre.

9 Rekomandim

Ne i rekomandojmë Kryetarit që të sigurojë se Komuna do të merr në konsiderim në vijim:

- Themelimin e kontrollit dhe të merr përgjegjësinë e duhur për të përmbushur kërkesat e raportimit të jashtëm financiar.

Ne i rekomandojmë Komunës të ndjek gjithë kërkesat e raportimit të MF.

7. Kontrolllet e menaxhmentit

7.1 Sistemi i kontrollit të brendshëm

Kemi identifikuar mangësi në pasqyrat vjetore financiare, menaxhimin e të hyrave, procedurat e prokurimit dhe menaxhimin e asetëve gjatë auditimit tonë siq është theksuar në këtë raport.

Konkluzion

Zbatimi aktual i kontrolleve të brendshme është në nivel të pamjaftueshëm.

10 Rekomandim

Ne i rekomandojmë Komunës që të sigurojë:

- Kontrolllet financiare administrative dhe menaxheriale të jenë përmirësuar; dhe
- Veprime të menjëhershme janë ndërmarrë duke siguruar trajtim më të mirë të mangësive në zbatimin e kontrollit të brendshëm.

7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm

Gjetjet

Komuna nuk ka krijuar një Komitet Auditimi dhe një funksion të Auditimit të brendshëm që gjithashtu është kërkuar nga rregullorja në fuqi nr. 03/L-128 dhe instruksioni administrative 11/2010 për themelimin dhe funksionin e komisionit të auditimit të brendshëm. Asnjë veprim nuk është ndërmarrë nga përgjegjësit për të adresuar këtë çështje e cila ishte raportuar vitin e kaluar në raportin tonë të auditimit të vitit kaluar.

Risku

Mungesa e funksionit të komitetit të Auditimit të Brendshëm rritë rrezikun e dështimit në kontrollet e brendshme. Më tepër, nuk lejohet zakonisht për funksionin e nga Komiteti i Auditimit të kryhet me pavarësi të duhur.

11 Rekomandim

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurojë që Komuna të ketë parasysh krijimin e funksionit të auditimit dhe Komitetin e Auditimit me anëtarët që kanë përvojën e duhur të raportimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. Komiteti Auditimit duhet të krijoj politika dhe procedura që të sigurojnë standarde të larta të qeverisjes. Komiteti Auditimit duhet të rishikoj statusin aktual dhe propozoj veprime për përmirësimin si ne vazhdim:

- Procesin e raportimit financiar dhe kontabël të Komunës;
- Vlerësimin e sistemin të kontrollit të brendshëm të implementuar nga Menaxhmenti;
- Procesin e Auditimit të jashtëm dhe të brendshëm;

8. Konkluzioni i përgjithshëm për Menaxhmentin e Komunës

Konkluzion i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se Menaxhmenti i Komunës nuk ka ndërmarr ende diçka për themelimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm plotësisht efektiv. Përveç disa përmirësimeve në fushën financiare dhe raportimit të aseteve, dobësitë janë vërejtur në disa fusha të Menaxhimit Financiar.

Menaxhmenti i Komunës duhet të zgjojë vetëdijen e menaxherëve dhe stafit për nevojën e kontrolleve. Korniza e PIFC-së duhet të shërbej si platformë për themelimin e kontrollit. Nevoja për rritje të transparencës dhe përgjegjësisë në të gjitha nivelet e organizatës është njëra nga kërkesat bazë për ndërtimin e strukturës së mirë qeverisëse.

Menaxhmenti i Komunës duhet gjithnjë të sigurojë raportim të besueshëm financiar dhe vlerësojë riskun e gabimeve materiale dhe gabimeve në pasqyrat financiare. Risku gjithashtu duhet të vlerësohet kur është fjala për menaxhimin e aseteve dhe të hyrave ku kompletimi i regjistrave dhe të dhënave mungon.

12 Rekomandim

Ne i rekomandojmë Komunës të sigurojë që:

- Politikat e qarta në të gjitha aktivitetet e rëndësishme të Komunës janë lëshuar dhe se një plan veprimi i cili specifikon veprime të menjëhershme për tu ndërmarrë është draftuar.
- Do të zbatojë rekomandimet tona në pikat 3 dhe 7.

Shtojca I.Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit bazuar në ISSAI 400.

(Marrë nga ISSAI 400)

Një opinion auditimi normalisht jepet në një format standard, dhe lidhet me pasqyrat financiare në tërësi, duke evituar kështu nevojën për të sqaruar gjerësisht se çfarë qëndron pas tij, por duke bërë të mundur për lexuesit nëpërmjet llojit të tij, të kuptuarit e përgjithshëm të domethënies së tij. Natyra e fjalëve do të ndikohet prej kornizës ligjore për auditimin, por përmbajtja e opinionit do të jetë e nevojshme të tregojë qartë nëse është i pakualifikuar apo i kualifikuar dhe, nëse është i kualifikuar, është i kualifikuar për disa aspekte apo është një opinion i kundërt ose një refuzim për të dhënë opinion.

Një **opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në çdo aspekt material për sa vijon:

- (a) Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza kontabël të pranueshme dhe politika të cilat janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme;
- (b) Pasqyrat janë në përputhje me kërkesat statutorë dhe rregulloret përkatëse;
- (c) Sipas njohurisë së auditorit mbi njësinë e audituar, pamja e paraqitur nga pasqyrat financiare është e qëndrueshme; dhe
- (d) Pasqyrat financiare përmbajnë shpalosjet e duhura të informacionit për të gjitha çështjet materiale.

Theksim i çështjes. Në disa rrethana auditori mund të mendojë se lexuesi nuk do të jetë në gjendje të kuptojë drejt pasqyrat financiare nëse atij nuk i tërhiqet vëmendja për çështje të rëndësishme apo të pazakonta. Si parim i përgjithshëm, auditori që jep një opinion të pakualifikuar nuk u referohet aspekteve të pasqyrave financiare në opinion, nëse ky do keqinterpretohet si një kualifikim. Me qëllim evitimin e dhënies së kësaj përshtypje, referimet që kanë kuptimin e “tërheqjes së vëmendjes” paraqiten në një paragraf të veçantë prej opinionit. Megjithatë, auditori nuk duhet të përdorë një tërheqje vëmendje për çështje të cilat lidhen me mungesën e shpalosjes së duhur të informacionit në pasqyrat financiare, dhe as si një alternativë apo zëvendësuese të kualifikimit të opinionit.

Një auditor mund të mos jetë në gjendje të shprehë një opinion të pakualifikuar nëse ekziston ndonjë prej rrethanave të mëposhtme dhe sipas gjykimit të auditorit efekti i tyre në pasqyra financiare është ose mund të jetë material:

- (a) Ka pasur kufizim fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron nëse pasqyrat janë të paplota ose keqinterpretuese, ose nëse ka një shmangje të pajustificuar nga standardet kontabël të pranuar; ose
- (c) Ka pasiguri që ndikon në pasqyrat financiare.

Opinion i kualifikuar. Kur auditori nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shume zëra të veçantë të pasqyrave financiare, të cilët janë materiale por jo thelbësore për të kuptuar pasqyrat, duhet dhënë një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm për auditimin, subjekt ky i një deklarate të qartë dhe koncize për çështjet për të cilat auditori ka kundërshtim apo të cilat krijojnë pasiguri që sjellin kualifikimin e opinionit. Përcaktimi sasior i efektit financiar që vjen prej pasigurisë apo kundërshtimeve nga ana e auditorit, i ndihmon përdoruesit e pasqyrave, megjithëse ky nuk është gjithmonë i mundur apo i rëndësishëm.

Opinion i kundërt. Kur auditori nuk është në gjendje të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare të marra në tërësi, për shkak të kundërshtimeve kaq thelbësore sa e dëmtojnë prezantimin e pozicionit në masën që një opinion i kualifikuar vetëm për disa aspekte do të ishte i papërshtatshëm, jepet një opinion i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë të paraqitura në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe shkurt të gjitha çështjet e kundërshtuara. Përsëri, përcaktimi sasior i efektit financiar ndihmon përdoruesit e pasqyrave, nëse një gjë e tillë është praktike dhe e rëndësishme.

Refuzim (Mohim) për të dhënë Opinion. Kur auditori nuk është në gjendje të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare të marra në tërësi, për shkak të një pasigurie apo një kufizimi të qëllimit, kaq thelbësor sa një opinion i kualifikuar vetëm për disa aspekte do të ishte i papërshtatshëm, jepet një refuzim për të dhënë opinion. Formulimi i një refuzimi të tillë bën të qartë se nuk mund të jepet një opinion, duke specifikuar qartë dhe shkurt çështjet e pasigurta. Për SAI është e zakonshme që të jepet një raport i detajuar që sqaron opinionin në rrethana kur nuk është e mundur të jepet një opinion i pakualifikuar.

Shtojca II.Rekomandimet nga viti paraprak

Elementet e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet e zbatuara plotësisht	Pjesërisht të adresuara	Të pa-adresuara
1. Përgatitja e pasqyrave financiare	Përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përmbajë procedura dhe mjete të përcaktuara për të siguruar që informacioni i kërkuar është regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar drejtë në pasqyrat financiare.	Pjesërisht	Komuna ka ndërmarr veprime të zbatojë rekomandimet në lidhje me asetet por nuk i zbatuar plotësisht.	
2. Prona, objektet dhe paisjet	<p>Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të konsiderojë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Rakordoj dhe mbajë regjistrin gjithëpërfshirës të aseteve me prezantimet në pasqyra financiare; -Të përfshijë burime shtesë në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe certifikuar është e rekomandueshme dhe praktika më e mirë në raste të tilla; -Të bëjë numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën e pasurive dhe 	Pjesërisht		

	<p>kushteve te tyre dhe te barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe regjistër.</p> <p>-Të bëje përpjekje në lidhje shtimin e vlerës së aseteve të kapitalizuarae</p>			
3.Të hyrat	<p>Ne rekomandojmë Kryetarin të sigurohet që Komuna të ndërmer hapa të përmirësojë sistemin e faturimit dhe kontabilitetit në mënyrë që të sigurojë kontroll të sigurt,eficient dhe efektiv në faturimin dhe të hyrat.</p> <p>Përmirësimi i procedurave lidhur me sistemin e tillë do ti mundësonte Menaxhmentit të monitoroj dhe menaxhoj rreziqet e rëndësishme, dhe të siguroj që vendimet lidhur me buxhetin, planifikimin dhe mbledhja e të hyrave bëhen në mënyrë të duhur. Ne rekomandojmë Komunës që:</p> <p>-Të implementojë sistemin e faturimit që përfshinë detaje të rifreskuara në lidhje me pagesit, adresat e tyre të tanishme, historinë, dhe shkallën e mbledhshmërisë. Në informacionin e tillë duhet të kenë qasje vetëm një numër i limituar i personelit dhe me</p>	Jo	Ne nuk kemi gjetur ndonjë mos-përputhshmëri me rregullore për tatime.	

	<p>autorizim të Menaxhmentit</p> <p>-Të regjistroj dhe të kontrolloj tarifatat e aprovuara dhe shkallët tatimore në sistem në mënyrë që të kalkulohen dhe gjenerohen faturat automatikisht. Gjenerimi i faturës gjithashtu të autorizohet dhe rishikohet</p> <p>-Ndërlidh automatikisht sistemin e faturimit me sistemin e softuerit të kontabilitetit ashtu që informacioni procesohet automatikisht në librin kryesor.</p> <p>-Kryej rakordime të rregullta midis dy sistemeve për të gjitha llojet e të hyrave. Çfarëdo diference duhet të largohet me përpikëri dhe shlyhet në baza kohore</p> <p>-Ne i sugjerojmë Komunës të ndërmerri veprime dhe të bëjë përpjekje të fut sistemin e centralizuar të faturimit po ashtu edhe për klientët pas datës 31 Mars të vitit aktual. Futja e shënimeve në dhe kontrolli i centralizuar përgjatë tarifave të aprovuara dhe shkallëve tatimore në sistem duhet gjithashtu të krijohet në</p>			
--	---	--	--	--

	<p>mënyrë që të kalkuloohen dhe gjenerohen faturat automatikisht. Gjenerimi i faturave duhet të autorizohet dhe rishikohet</p> <p>-Të lidhet automatikisht njësinë operacionale me faturimin dhe kryerja e rekoncilimeve të rregullta në mes tyre, në rastet kur faturimi lidhet drejtpërdrejt me shërbimet e ofruara nga njësia operacionale. Kjo është posaçërisht e rëndësishme kur ekzekutohet numri i madh i transaksioneve</p> <p>-Ne sugjerojmë Komunën të mbanë komunikim të përhershëm me qendrën e regjistrimit të bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë lidhur me bizneset të cilat operojnë në Komunë dhe të ngarkohen për tatimet e përshkruara sipas Ligjeve dhe Rregulloreve</p> <p>-Siguroj ndarjen e duhur të detyrave.</p>			
4.Shpenzimet	Komuna duhet të jetë në dijeni dhe të ketë kujdes të bëjë pagesa nga kodet adekuate ekonomike në mënyrë që të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e	Po		

	Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësisë (“LMFPP”) nr.03/L-048 dhe Udhëzimit Administrativ të Thesarit 02/2009. Për më tepër, të gjitha pagesat duhet të kenë dokumente mbështetëse origjinale.			
4.1 Pagesat (pagat dhe rrogat)	Komuna duhet të krijoj procedura adekuate të kontrollit të brendshëm në mënyre që të siguroj përputhshmërinë me ligje dhe rregullore	Po		
4.2 Prokurimi	Komuna duhet të ketë stafin e tyre teknik profesional apo të angazhoj nga jashtë staf profesional në projekte të caktuara në mënyrë që të certifikon kualitetin e punëve siç përcaktohet në kërkesat e Komunës. Ne i rekomandojmë Kryetarit që të siguroj që Komuna të ndërmer hapa të mëtutjeshme të kontrollit përgjatë shpenzimeve dhe pagesave dhe të ketë pajtueshmëri strikte me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.		Ne kemi gjetur disa raste të vonesës së punëve të cilat nuk janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi	

4.3 Subvencionet dhe transferet	Komuna duhet të themelojë procedura të kontrolleve adekuate të mjaftueshme për monitorimin efektiv në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret aplikative.		Komuna nuk ka ndërmarr ndonjë veprim për të themeluar procedurat të kontrollit të brendshëm për minitorimin e përputhshmëris me ligje dhe regilloret	
5. Auditimi i brendshëm	<p>Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurojë që Komuna të ketë parasysh krijimin e funksionit të auditimit dhe Komitetin e Auditimit me anëtarët që kanë përvojën e duhur të raportimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. Komiteti Auditimit duhet të krijoj politika dhe procedura që të sigurojnë standarde t të larta të qeverisjes. Komiteti Auditimit duhet të rishikoj statusin aktual dhe propozoj veprime për përmirësimin si ne vazhdim:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Procesin e raportimit financiar dhe kontabël të Komunës; -Vlerësimin e sistemin të kontrollit të brendshëm të implementuar nga Menaxhmenti; -Procesin e Auditimit të jashtëm 		Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për themelimin e Komitetin të Auditimit dhe funksionimin e auditimit të brendshëm	

	<p>dhe të brendshëm;</p> <p>-Përputhshmërinë, raportimin dhe strukturat e kontrollit për gjithë Komunën që të sigurohet pajtueshmëria me kërkesat rregullative dhe legale;</p> <p>-Plani Auditimit të brendshëm dhe përcjellja e gjetjeve të Auditimit të brendshëm</p>			
--	---	--	--	--

Shtojca III.Komentet e Komunës dhe përgjigjja e Auditorit

Rekomandim	Pajtimi	Pjesërisht pajtohet	Nuk pajtohet	Komentet nga Komuna	Përgjigjja e auditorit
Rekomandimi 1:					
Rekomandimi 2:					
Rekomandimi 3:					
Rekomandimi 4:					
Rekomandimi 5:					
Rekomandimi 6:					
Rekomandimi 7:					
Rekomandimi 8:					
Rekomandimi 9:					
Rekomandimi 10:					

Nuk ka përgjegje nga asnje departament lidhur me rekomandimet tuaja lidhur me auditimin e pasqyrave financiare per vitin 2011.



Grant Thornton

An instinct for growth™

www.grant-thornton.com.mk